

**PROTOKOLLI Nr. 2**  
**I KONVENTËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE,QË I ATRIBUON**  
**GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT KOMPETENCËN PËR TË DHËNË**  
**MENDIME KONSULTATIVE**

**Strasbourg, 6.V.1963**

Protokolli Nr. 2 (ETS Nr. 44) ka qenë një pjesë përbërëse e Konventës që nga data e hyrjes së saj në fuqi, më 21 shtator 1970. Megjithatë, të gjitha dispozitat e ndryshuara ose të shtuara nga ky Protokoll janë zëvendësuar nga Protokolli Nr. 11 (ETS Nr. 155) që nga data e hyrjes së saj në fuqi, më 1 nëntor 1998.

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkrues të këtij Protokolli,

Duke marrë parasysh dispozitat e Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950 (e quajtur më pas “Konventa”) dhe, kryesisht Nenin 19 që parashikon krijimin, ndër organe të tjera, të një Gjykate Evropiane të të Drejtave të Njeriut (e quajtur më pas si “Gjykata”);

Duke e konsideruar të përshtatshme që t’i akordohet Gjykatës kompetenca për të dhënë, në disa kushte, mendime konsultative,

Kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

1. Gjykata mund, me kërkesën e Komitetit të Ministrave, të japë mendime konsultative për çështje juridike lidhur me interpretimin e Konventës dhe të Protokolleve të saj.

2. Këto mendime nuk shqyrtojnë çështje të lidhura me përmbajtjen ose shtrirjen e të drejtave apo të lirive të përcaktuara në titullin 1 të Konventës dhe të Protokollit të saj, ose me çështje të tjera që mund t’i paraqiten për shqyrtim Komisionit, Gjykatës apo Komitetit të Ministrave si pasojë e çdo procedure të tillë siç mund të krijohet në përputhje me Konventën.

3. Vendimet e Komitetit të Ministrave për të kërkuar një mendim konsultativ të Gjykatës merren me një shumicë votash prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

Neni 2

Gjykata vendos nëse kërkesa për një mendim konsultativ e paraqitur nga Komiteti i Ministrave hyn në kompetencën e tij konsultative siç përcaktohet nga Neni 1 i këtij Protokolli.

Neni 3

1. Për shqyrtimin e kërkesave për një mendim konsultativ, Gjykata mbledhet në seancë plenare.
2. Mendimet konsultative të Gjykatës duhet të arsyetohen.
3. Në qoftë se mendimi nuk shpreh krejtësisht ose pjesërisht mendimin unanim të gjykatësve, çdo gjykatës ka të drejtë të japë një mendim individual.
4. Mendimet konsultative të Gjykatës i komunikohen Komitetit të Ministrave.

Neni 4

Në zgjerim të kompetencave që i jep Neni 55 i Konventës dhe në përshtatje me qëllimet e këtij Protokollit, Gjykata mund, nëse e gjykon të nevojshme, të vendosë rregulloren e saj dhe të përcaktojë procedurën që do të ndjekë.

## Neni 5

1. Ky Protokoll i paraqitet për nënshkrim Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkrues të Konventës, të cilët mund të bëhen Palë me anë të:

- a) nënshkrimit pa rezerva në lidhje me ratifikimin ose pranimin;
- b) nënshkrimit me rezerva në lidhje me ratifikimin ose pranimin, pasuar nga ratifikimi ose pranimi.

Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi sapo të gjithë Shtetet Palë të Konventës do të bëhen Palë të Protokollit, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni.

3. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit, Nenet 1 deri 4 do të konsiderohen si pjesë përbërëse të Konventës.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit për:

- a) çdo nënshkrim pa rezerva në lidhje me ratifikimin ose pranimin;
- b) çdo nënshkrim me rezerva në lidhje me ratifikimin ose pranimin;
- c) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi ose pranimi;
- d) datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Strasburg, më 6 maj 1963, në Anglisht dhe Frëngjisht, ku të dy tekstet janë njëloj autentikë, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm do t'u dërgojë kopje të njësuara me origjinalin secilit Shtet nënshkrues.